



INSTITUTI PER DEMOKRACI DHE NDERMJETESIM

Rr Shenasi Dishnica Nr. 37, POBOX: 8177, Tirana, Albania,

Tel: +355 4 240 0241; Tel/Fax: +355 4 240 0640

E-mail: info@idmalbania.org

Website: www.idmalbania.org

Dokument
Politikash

Ndërtimi i një Politikëbërje me qendër qytetarin

Perspektiva globale dhe Praktikrat më të mira

Dhjetor 2008

PËRMBLEDHJE

	Fq.
<i>Falenderime</i>	3
<i>Përmbledhje</i>	4
I. Konteksti	5
II. Përse është e rëndësishme pjesëmarrja e qytetarëve në politikëbërje	7
III. Pjesëmarrja e publikut: Aktorët dhe sfidat	9
IV. Procesi i politikave dhe pjesëmarrja e qytetarëve	11
V. Parimet, mekanizmat dhe mjetet	13
VI. Ndikimi i pjesëmarrjes së qytetarëve mbi politikat: Të dhëna dhe statistika	16
VII. Praktikat më të mira dhe modele	17
VIII. Raste studimore vendesh	20
IX. Alternativa politikash dhe rekomandime	24
Bibliografi	26

Falenderime

IDN – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dëshiron të falenderojë Programin për Mbështetje Institucionale të Fondit Think Tank të OSI-it me anë të të cilit u mundësua publikimi i këtij dokumenti politikash i cili është në përputhje me përqasjen strategjike të IDM-së dhe filozofinë e projektit, i cili ka mundësi të ketë një ndikim pozitiv mbi fushat e politikave dhe dokumentat e miratuara nga institucionet shtetërore përkatëse. Në këtë kontekst, alternativat e politikave të prezantuara këtë dokument dhe debati mbi këto politika ka si qëllim të promovojë jo vetëm impenjimin e organizatës për të rritur kapacitetet e saja kërkimore në analiza mbi politikat publike por mbi të gjitha angazhimin e saj për të mbështetur politikëbërjen në partneritet me shume institucione qeverisëse në nivel kombëtar dhe lokal. Një falenderim i veçantë shkon për stafin e IDN-së mbështetja e të cilëve me të dhëna dhe kërkime si dhe duke ofruar kontributin e tyre mbi rastin studimor/”case study” në këtë dokument politikash, ka qenë një burim i çmuar.

Artan Karini, M.P.A.
Konsulent, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

PËRMBLEDHJE

Marrëdhënia midis pjesëmarrjes së publikut dhe bërjes së politikave publike është e rëndësishme dhe e dobishme për t'u studiuar për një sërë arsyesh të ndryshme. Në fakt, në kontekstin global, ka një vëmendje të konsiderueshme mbi marrëdhënien e qeverisë dhe publikut mbi çështje shumë të nxehta si për shembull përgjegjshmëria dhe trasparenca e qeverisë, të cilat janë kthyer në tema debati në dekadën e fundit. Shoqëria civile në vetvete – brenda qëllimit të saj për t'i dhënë zë qytetarëve dhe komuniteteve – ka qënë faktori më i fuqishëm në përmirësimin e marrëdhënieve qytetar - qeveri. Gjithashtu, ndryshimet e realitetit politik, social dhe kulturor midis shteteve kanë qënë tradicionalisht themelore në procesin e përfshirjes së qytetarëve në zhvillimin e politikave.

Ka një sërë përfitimesh që lidhen me përfshirjen e qytetarëve në procesin e politikëbërjes. Përveç transparencës, përgjegjshmërisë dhe legjitimitetit, arritja e mirëkuptimit midis komuniteteve dhe vendimarrësve duhet konsideruar si qëllimi final i pjesëmarrjes së publikut në procesin e politikëbërjes. Ndërtimi i konsensusit midis qeverive dhe komuniteteve çon në një politikë publike gjithëpërfshirëse, demokratike dhe mbi të gjitha të një cilësie të lartë, e cila reflekton interesin publik përballë axhendave politike në nivele të ndryshme qeverisëse. Politikat publike të mirëinformuara dhe gjithëpërfshirëse kanë më shumë gjasa për të promovuar një ambient socio-ekonomik pozitiv, në të cilin mirëbesimi në institucione rrënjohet. Pjesëmarrja e qytetarëve ndihmon në zgjidhjen efektive të konflikteve jo vetëm në nivel kombëtar por edhe në nivel global.

Ky dokument analizon procesin e politikëbërjes dhe përqendrohet mbi faktin se si qytetarët i përshtaten kuadrin të përgjithshëm (ose procesit). Referime u bëhen aktorëve kyç dhe institucioneve si përgjegjës për zbatimin efektiv të mekanizmave dhe mjeteve të përcaktuara për një pjesëmarrje kuptimplotë në politikëbërje nëpërmjet informimit ose/dhe konsultimeve me qytetarët për të siguruar pjesëmarrje aktive. Informacioni dhe konsultimet përfaqësojnë përkatësisht një marrëdhënie një drejtimëshe dhe dy drejtimëshe (one-way/two-way), në të cilën qeveritë ose qëndrojnë larg, ose marrin informacion dhe reagim nga publiku. Nga ana tjetër, pjesëmarrja aktive e publikut është një marrëdhënie e bazuar në partneritet me qeverinë në të cilën qytetarët përfshihen aktivisht për të përkufizuar procesin dhe përmbajtjen e politikëbërjes.

Duke u bazuar në një literaturë gjithëpërfshirëse, ky dokument ofron disa shembuj të praktikave më të mira për pjesëmarrjen e qytetarëve në politikëbërje nga një perspektivë globale. Në këtë dokument theksohet ndikimi i pjesëmarrjes së qytetarëve për zhvillimin e politikave. Gjetjet kyçe mbi marrëdhënien e përfshirjes së qytetarëve dhe zhvillimin e politikave janë ilustruar nëpërmjet të dhënave dhe statistikave. Mbi të gjitha, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN) – duke qënë një think – tank i angazhuar për promovimin e pjesëmarrjes qytetare në procesin e vendim-marrjes lokale dhe rritjen e përgjegjësisë së aktorëve vendimmarrës në nivel lokal vis-à-vis popullsisë nëpërmjet një përjasje nga poshtë/lart (bottom-up/top-down) – ofron eksperiencën e saj për institucionalizimin e strukturave të ndërmjetësimit dhe mekanizmat e kohezionit social si “ndërlidhësi komunitar” dhe “grupet me bazë komunitare” në përpjekje për të promovuar pjesëmarrjen në qeverisje të qytetarëve. Rasti i studimit (case study) është ballafaquar dhe është përqëndruar përreth praktikave më të mira të analizuar në këtë dokument.

Së fundmi, alternativat e politikave duke patur parasysh përfitimet e pjesëmarrjes së qytetarëve në politikëbërje janë debatuar nga një perspektivë teorike duke përmbledhur kështu gjetjet kyçe të këtij dokumenti politikash.

I. Kontekst

Pjesëmarrja e publikut në politikëbërje është themelore për të qeverisur në një demokraci. Në procesin e tranzicionit drejt demokracisë, qeveritë nuk kanë më autoritet automatik por duhet të rivendosin vazhdimisht autoritetin e tyre nëpërmjet qeverisjes së përgjegjshme. Duke ditur këtë, autoriteti final politik i përket popullit. Qeverisja kërkon pjesëmarrjen e publikut dhe diskutimin publik për të qeverisur në mënyrë efektive dhe me një sens përgjegjësie përkundrejt publikut të gjerë. Qeveritë që aktivisht nxisin kontributin e publikut në proceset politikëbërëse janë në gjendje të përmbushin arritjet e tyre duke u mbështetur në pjesëmarrjen e publikut. Pjesëmarrja e publikut krijon gjithashtu politika publike më të mira sepse vendimet lokale merren në komunitet dhe janë bashkim përpjekjesh të cilat rezultojnë të jenë vendime më të arsyeshme dhe të menduara mirë¹. Sa u tha më sipër përbën bazat për të cilat marrëdhënia midis pjesëmarrjes së publikut dhe politikëbërjes publike është sa e rëndësishme aq dhe interesante për t'u studiuar.

Lajmi i mirë qëndron në faktin se midis përpjekjeve për të luftuar korrupsionin në nivel ndërkombëtar dhe për të gjetur zgjidhje për krizën financiare globale, ka një vëmendje më të madhe mbi marrëdhënien e qeverisë me publikun mbi çështje të nxehta si përgjegjshmëria e qeverisë dhe trasparenca, të cilat kanë qënë gjithmonë e më shumë subjekt i debatit publik sidomos në dekadën e fundit. Pikërisht për shkak të gjendjes globale aktuale janë zhvilluar mjaft studime të mëtejshme dhe kërkime mbi pjesëmarrjen e publikut si koncept. Veç kësaj, ndërkohë që mundësitë për reagime dhe konsultime (midis qeverisë dhe qytetarëve) janë në rritje, ka diferenca të mëdha midis vendeve me traditë të konsoliduar të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe atyre vendeve që sapo kanë filluar ta hapin vendim-marrjen e qeverisë ndaj qytetarëve në nivel ndërkombëtar.²

Konteksti politik është (ndoshta) faktori më i rëndësishëm rreth lidhjeve të politikave të shoqërisë civile. Një nga arsyet për praninë e këtij faktori është që qeveritë nuk kanë burime të mjaftueshme për të siguruar kontributin e qytetarëve për zhvillimin e politikave të tyre. Faktorë të tjerë që kanë të bëjnë me praninë e faktorit politik në nivelin e angazhimeve të shoqërisë civile në politikëbërje përfshin kundërshtime të disa zyrtarëve të administratës publike për përfshirjen e qytetarëve në vendim-marrjen e qeverisë, interesa politike konfliktuale, mungesë transparence dhe përgjegjshmërie si dhe mungesë të organeve ligjëvënëse (sidomos në sisteme institucionale të dobëta) për të siguruar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në politikat publike.

Disa mbikëqyrës kanë përqëndruar vëmendjen mbi çështje si kapaciteti, kompetenca, ekspertiza dhe aftësia mobilizuese si faktorë të brendshëm kyç për të prekur ndikimin e organizatave të shoqërisë civile në proceset e politikave. Gjithashtu, konteksti socio-kultural

¹ Adams, 1997

² Fioramonti, L. & Heinrich, V. Finn, 2007

ndryshon nga një shoqëri në tjetrën, dhe mund të jetë ose ndihmues ose dëmtues ndaj procesit të ndikimit të shoqërisë civile në politikëbërje. Një rast i tillë do të ishin vendet, në të cilat marrëdhënia e tripartiteve midis qeverisë, biznesit dhe sindikatave (si rasti i Italisë, Luksemburgut dhe Irlandës) ose në dallim, rasti i Europës Juglindore ku koncepti i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendim-marrjen e qeverisë është relativisht i ri.

Në pjesën më të madhe të vendeve post-komuniste të Europës Lindore, pjesëmarrja publike në vetvete ka ndikuar si me anë të trashëgimisë të së kaluarës dhe pasojat e lidhura me tranzicionin nga një shoqëri diktatoriale në një shoqëri demokratike. Me rënien e komunizmit në këto shoqëri duke ndjekur ndryshimet e udhëhequra nga grupet civile, niveli i pjesëmarrjes ka rënë ndjeshëm edhe pse shoqëritë civile kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rrëzimin e qeverive komuniste në këto vende. “Këto eksperiencat tregojnë se shoqëritë civile në Europën post-komuniste – aspak për shkak të ideologjisë së tyre anti-shtet – funksionojnë më mirë si një instrument proteste sesa si një platformë veprimi”³.

Elementë të tjerë të cilët kanë kontribuar në përqindjet e ulëta të pjesëmarrjes në vendet e Europës Lindore kishin të bëjnë me dobësitë brenda shoqërisë civile në këto vende si për shembull lidhjet e dobëta midis shoqërisë civile dhe popullsisë, shoqëria civile elitare nuk i përgjigjet nevojave të qytetarëve, transparencat dhe praktikatat e dobëta të përgjegjshmërisë të shoqërisë civile, si dhe udhëheqja e shoqërisë civile nga donatorët. I tillë është rasti i shumë organizatave të shoqërisë civile (OSC), të cilat janë krijuar më tepër në përgjigje të mundësive për ngritje fondesh sesa për t’iu përgjigjur nevojave të popullatës, prandaj prania e tyre në debatet e politikave është e diskutueshme. “Nuk është e çuditshme që, në një situatë të tillë OSC-të shpesh fokusojnë vëmendjen e tyre mbi prioritetet e donatorëve sesa në nevojat e shoqërisë”⁴.

Ekzistojnë mekanizmat të ndryshëm dhe disa nivele të pjesëmarrjes së publikut në kuptimin më të gjerë të konceptit tonë dhe në politikëbërje në veçanti. Ndërkohë që pjesëmarrja e publikut është mjeti që i lejon të gjitha segmentet e shoqërisë të marrin pjesë aktivisht në vendim-marrje, politika publike është një koncept më i gjerë që përfshin politika për shoqërinë dhe komunitetin – një konsensus të qeverisë dhe të të qeverisurve. Qytetarët realisht marrin pjesë në shoqëri me një mori rrugësh të ndryshme. Ata shprehin dëshirat dhe kërkesat e tyre duke nënshkruar peticione dhe duke bojkotuar produktet; ata mbështesin pretendime dhe interesa specifike duke dhuruar para, kontribuojnë në bamirësi dhe asistojnë të afërmit dhe fqinjët; anëtarësohen në organizata dhe shoqata për të arritur qëllime kolektive dhe mund të angazhohen me programe ripërtëritjeje për të përmirësuar cilësinë e jetës në lokalitetet e tyre. Faktikisht, lista e aktiviteteve të qytetarëve në shoqërinë civile është praktikisht e pakufizuar. Gjatë dekadës së fundit shumë vende kanë përjetuar një rritje të paprecedentë në numrin e personave të përfshirë në këtë pafundësi aktiviteteve si dhe zgjerimin e vazhdueshëm të modeleve të pjesëmarrjes në vendim-marrje.

Për të angazhuar pjesëmarrjen qytetare në vendim-marrje, ne duhet të shohim mënyrat se si qeveria mund dhe duhet të shpërndajë informacionin në shoqëri – elementi kyç për pjesëmarrjen qytetare në politikëbërje si dhe përgjegjësitë dhe detyrimet të cilat vetë qytetarët duhet ti dinjë në mënyrë që të sigurohet një pjesëmarrje kuptimplotë në konsultime për vendim-

³ Fioramonti, L. & Heinrich, V. Finn, 2007

⁴ Carothers, 2000

marrje. Aksesimi mbi informacionin kërkon legjislacion të sigurt, mekanizma institucional të qartë për aplikimin e tij, dhe institucione të pavarura mbikëqyrëse dhe gjyqësorin për zbatueshmërinë. Në fund, është e nevojshme që qytetarët të njohin dhe kuptojnë të drejtat e tyre – si dhe të kenë vullnetin dhe të jenë në gjendje t'i pranojnë ato. Të ndihmuar nga zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit, aksesimi i publikut mbi informacionin për qëllim pjesëmarrjen në vendim-marrje sigurisht që duhet kufizuar mbi informacionin i cili zakonisht nuk përfshin konfidencialitetin që i shmanget publikut.

Mbi të gjitha, pjesëmarrja e publikut mund të jetë si pasive dhe aktive. Pjesëmarrja pasive ndodh kur qeveritë shpërndajnë informacion në një drejtim, ndërkohë që me përkufizim “pjesëmarrja aktive shihet si një marrëdhënie e cila bazohet në partneritet me qeverinë, në të cilën qytetarët angazhohen aktivisht për të përcaktuar procesin dhe përmbajtjen në vendim-marrje. Pjesëmarrja aktive njeh kapacitetin e qytetarëve për të diskutuar dhe prodhuar në mënyrë të pavarur alternativa politikash. Ajo kërkon që qeveritë të ndajnë një axhendë dhe të sigurojnë që propozimet e politikave të prodhuara së bashku, do të merren parasysh për të arritur vendimin final”⁵. Me fjalë të tjera pjesëmarrja aktive nënkupton që, përveç arritjes së konsensusit midis qeverisë dhe komuniteteve mbi përdorimin e burimeve të kufizuara, kujtdo në komunitet i lejohej të thotë fjalën e tij mbi mënyrën se si taksat duhen shpenzuar.

Megjithatë, duke qenë se pjesëmarrja e publikut nuk çon në rezultate përfundimtare, është e rëndësishme që të kushtohet vëmendja e duhur mbi efektet e komunikimit mbi pjesëmarrjen e publikut dhe si rrjedhojë, mbi politikëbërjen. Ndërkohë që komunikimi është nganjëherë i njëanshëm, duke marrë kështu formën e një transferimi të thjeshtë të informacionit, pjesëmarrja e publikut në vetvete është e dyanshme, dhe shpesh është komunikim multidimensional. Pa komunikim dhe pjesëmarrje të publikut, do të ketë diferencime të papajtueshme midis qeverisë përgjegjëse mbi vendim-marrjen politike dhe komuniteteve që përfitojnë nga ajo; ndërsa me komunikim dhe pjesëmarrje të publikut, mund të arrihet konsensusi i nevojshëm për shpërndarjen e burimeve të kufizuara. Për sa i përket formulimit, hartimit dhe politikëbërjen, komunikimi merr një rëndësi të veçantë në procesin e politikëbërjes meqenëse shërben si një lidhës midis identifikimit të çështjeve të politikave dhe diskutimit me grupet e përfshira. Zakonisht kjo zbatohet nëpërmjet konsultimeve me shoqërinë, e cila si në rastin e pjesëmarrjes së publikut është një proces i dyanshëm.

II. Përse është e rëndësishme pjesëmarrja e qytetarëve në politikëbërje

Procesi i pjesëmarrjes së publikut në politikëbërje është tepër i rëndësishëm. Faktikisht, përfitimet e pjesëmarrjes së publikut përparojnë gjatë vetë procesit por, mbi të gjitha, pjesëmarrja e publikut krijon politika më të mira sepse vendimet lokale janë të tilla ku përpjekjet kolektive zakonisht rezultojnë si vendime më të arsyeshme dhe të menduara mirë⁶. Megjithatë, nuk ka një përkufizim të vetëm të pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje; nga ana tjetër, karakteristika unike e pjesëmarrjes së publikut konsiston në faktin që nuk çon në konkluzione dhe vendime përfundimtare.

⁵ Caddy, J. & Vergez, C., 2001

⁶ Adams, J., 1997

Ka përfitime të shumta që lidhen me pjesëmarrjen e qytetarëve në politikëbërje. Duke u nisur nga kushti paraprak që qëllimi ideal i pjesëmarrjes së publikut është që të ndihmojë ndërtimin e konsensusit midis qeverisë dhe komuniteteve në lidhje me vendimet që prekin interesin publik, pjesëmarrja e publikut mund të çojë në një sërë përfitimesh të drejtëpërdrejta. Përveç ndërtimit të konsensusit, mund të ndihmojë për të shpërndarë konfliktet, të decentralizojë fuqinë dhe të prodhojë vendime efektive dhe të shpejta nga të cilat përfiton publiku i gjerë.

Edhe kur konsensusi nuk mund të arrihet, përpjekjet për të angazhuar publikun në vendim-marrje mund të ketë përfitime indirekte dytësore si për shembull shmangia e konflikteve të ardhshme midis komuniteteve dhe vendimarrësve; ndërtimin e marrëdhënieve jo vetëm midis këtyre të fundit por gjithashtu edhe midis aktorëve të tjerë të përfshirë në debatin mbi politikën; sigurinë. Në këtë mënyrë vendimet e marra kanë lidhje me nevojat e komunitetit, i cili në vetvete mund të ndihet krenar dhe i fuqizuar thjesht nga fakti që është ftuar për të marrë pjesë në vendim-marrje. Mbi të gjitha dhe më e rëndësishmja, arritja e mirëkuptimit midis komunitetit dhe vendimarrësve – jo thjesht arritje konsensusi – duhet të jetë qëllimi final i pjesëmarrjes së publikut si një vlerë e shtuar në procesin vendimarrës.

Ndërtimi i konsensusit midis qeverive dhe komuniteteve çon përfundimisht në një politikë publike gjithëpërfshirëse, demokratike dhe mbi të gjitha të një cilësie më të lartë, e cila reflekton interesin e publikut përkundrejt axhendave politike në nivele të ndryshme qeverisëse. Politikën publike gjithëpërfshirëse dhe të mirëinformuara kanë më shumë mundësi të promovojnë një ambient pozitiv socio-ekonomik, në të cilin mirëbesimi i publikut tek institucionet është i rrënjësor. Gjithashtu, fuqizimi i marrëdhënieve të qeverisë me qytetarët mund të shihet si një investim i sigurt në përthithjen e burimeve të reja mbi ide të rëndësishme politikash, informacioni dhe burime për implementim⁷. Prandaj, shumë qeveri progresiste në ditët tona e shohin ndërtimin e marrëdhënieve të mira me qytetarët e tyre si një investim, dhe qëndrimin e qytetarëve nëpërmjet kontributit të tyre në politikën qeverisëse si “frytë të këtij investimi”.

Pjesëmarrja qytetare ndihmon në zgjidhjen reale të konflikteve jo vetëm në lidhje me politikëbërjen globale por në mënyrë specifike, në lidhje me sigurinë njerëzore globale. Përfaqësimi dhe pjesëmarrja reale e qytetarëve në proceset vendimarrëse të institucioneve ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe ata të përfshirë në përgjigjen ndaj konfliktit, sjell një nivel të ri të përgjegjshmërisë demokratike mbi politikën e formuluar për të inkurajuar sigurinë njerëzore, përfshirë këtu edhe përdorimin potencial të forcës. Eksperienca e proceseve demokratike në zhvillim, në nivel kombëtar dhe rajonal, ka treguar që përfshirja organeve të përfaqësive qytetare ka dhënë një kontribut të rëndësishëm për të negociuar dhe zgjidhur çështje shumë të përfolura, duke reduktuar legjitimitetin dhe përdorimin de fakto të forcës ushtarake⁸.

Transparenca dhe përgjegjshmëria duhet gjithashtu të konsiderohet si një përfitim i drejtëpërdrejtë dhe indirekt i pjesëmarrjes së qytetarëve në politikëbërje. Sigurisht, transparenca duke qenë një nocion sa kompleks aq edhe i paqëndrueshëm në vetvete, kërkon që qytetarët të shprehin angazhim mbi proceset e politikave duke shqyrtuar të gjitha burimet e informacionit në mënyrë të tillë që pjesëmarrja e tyre të çojë në vendime politikash të mirëinformuara. Prandaj, aksesimi mbi informacionin, konsultimet dhe pjesëmarrja aktive në vendim-marrje kontribuon në

⁷ Caddy J. & Vergez C., 2001

⁸ LogoLink International Workshop on Resources: Citizen Engagement and Democratic Local Governance, 2004

mirëqeverisje duke promovuar transparencë më të madhe në politikëbërje; më tepër përgjegjshmëri nëpërmjet ekzaminimit të drejtpërdrejtë të publikut dhe kontrollit; legjitimitet më i madh i proceseve vendimarrëse në qeverisje; vendime më cilësore mbi politika të bazuara mbi burime informacioni më të plota; dhe së fundmi, nivele më të larta implementimi dhe pëlqimi falë ndërgjegjësimit më të lartë të publikut mbi politikat dhe pjesëmarrjen në projektimin e tyre⁹.

Së fundmi, por më e rëndësishmja, pjesëmarrja e publikut është e dobishme në konsolidimin e mirëqeverisjes nëpërmjet aplikimit të koncepteve dhe praktikave më moderne dhe efektive si pjesëmarrja aktive (drejt konsultimeve të thjeshta me qytetarët), tripartiteve si dhe futja e TIK (Teknologjite e Informacionit dhe Komunikimit) në vendet ku këto koncepte dhe praktika kanë munguar plotësisht në të kaluarën siç është rasti i vendeve ish-komuniste.

III. Pjesëmarrja e publikut: Aktorët dhe sfidat

Debati mbi procesin e pjesëmarrjes së publikut në politikëbërje nuk do të kishte kuptim pa një diskutim të thellë mbi rolin e disa aktorëve kyç të përfshirë në këtë proces si dhe ndërveprimin midis këtyre aktorëve si nxitës për një proces kuptimplotë të pjesëmarrjes së publikut. Shtrirja e aktorëve që përfshihen dhe lehtësojnë këtë proces është e gjerë.

Teoricienët dhe profesionistët që e konceptojnë pjesëmarrjen e publikut si një dialog me të, besojnë se aktorët që marrin pjesë në debatet mbi politikat dhe në vendim-marrje përfshijnë dhe qytetarët e thjeshtë, individët, grupet e interesit, organizatat jo-qeveritare, mediat, shoqatat profesionale dhe sociale, etj – të cilët karakterizohen nga nivele të ndryshme pjesëmarrjeje – mbartin filozofinë që të paktën të gjithë qytetarët kanë të drejtën për t'u informuar rreth qeverisë së tyre dhe të marrin vendime individuale rreth nivelit të pjesëmarrjes në proceset vendimarrëse të qeverisë¹⁰.

Së pari dhe më kryesorja, *qytetarët* përbëjnë grupin kryesor të interesit midis aktorëve pjesëmarrës në procesin e vendim-marrjes. Po të flitet gjerësisht, ka dy lloje kryesore të pjesëmarrjes qytetare: pjesëmarrje nëpërmjet aktiviteteve në komunitet jo-partizane ose pjesëmarrje nëpërmjet përfshirjes qytetare, profesionale dhe shoqatave vullnetare. Megjithatë, këto dy lloje pjesëmarrjeje janë gjithmonë të kushtëzuara nga konteksti gjeopolitik dhe socio-kultural në të cilin aktivizohet shoqëria civile. Në disa shoqëri, pjesëmarrja nëpërmjet aksioneve kolektive komunitare është më e përhapur. Në disa të tjera, anëtarësimi në shoqata profesionale apo qytetare është më tipik.

Megjithatë, pjesëmarrja qytetare nuk duhet parë si një koncept filozofik. Zbatimi i këtij koncepti nuk do të ishte efektiv nëse vetë qytetarët tregojnë vullnetin e tyre për të marrë pjesë aktivisht jo vetëm në procesin e politikave por edhe për të qënë të sigurt që ata do të përfshihen në të gjitha proceset politike të rëndësishme për funksionimin e qeverisë. Me fjalë të tjera, vetë qytetarët, kanë obligimet e tyre për të garantuar që pjesëmarrja e tyre të jetë kuptimplotë. Këto

⁹ Caddy J. & Vergez C., 2001

¹⁰ Adams, J., 1997

detyrime përfshijnë jo vetëm përgjegjësi qytetare si vota por edhe iniciativa qytetare për t'a mbajtur qeverinë përgjegjëse në mënyre konstante për aktivitetet e saj ose nëpërmjet veprimeve individuale ose nëpërmjet përpjekjeve kolektive si peticionet drejtuar qeverisë, mobilizimi i takimeve publike dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në lëvizje të shoqërisë civile (për tu diskutuar më vonë). Të gjitha këto forma na tregojnë se pjesëmarrja qytetare mund të ketë një impakt të fuqishëm në hapat e zhvillimit të politikave publike sidomos kur bëhet fjalë për të debatuar politika të ndryshme alternative në të cilat publiku ka interes të drejtpërdrejtë.

Qeveria është një aktor kyç për të garantuar që kontributi i publikut të nxitet në mënyrë konstante dhe të reflektohet në debatet mbi politikat dhe proceset vendimarrëse. Është përgjegjësi e qeverisë të bëjë të gjitha përpjekjet për përhirjen e qytetarëve në debatet publike si drejtpërsëdrejti dhe nëpërmjet institucioneve të shoqërisë. Pa nxitjen aktive të qeverisë mbi shqetësimet e publikut, qeveria ka gjasa të dëgjojë nga qytetarët vetëm kur ata kanë ankesa për qeverinë. Disa mënyra tipike, ku qeveritë mund të shfaqin detyrimet e tyre mbi pjesëmarrjen e publikut përfshin institucionalizimin e pjesëmarrjes qytetare nëpërmjet mbajtjes së dëgjësive publike ose mbledhjeve të hapura mbi veprime të caktuara të qeverisë, zhvillimin dhe/ose të infrastrukturës së projekteve/propozimeve si dhe dëgjësive mbi shpërndarjen e buxhetit bashkiak (në rastin e qeverisjes vendore).

Njëkohësisht, qeveritë mund të përdorin metoda tradicionale nëpërmjet të cilave tregohet vëmendja e qeverisë mbi shqetësimet e qytetarëve dhe komunitetit si për shembull përgjigja ndaj ankesave dhe kërkesave për informim të jetë në kohë dhe efektive. Në disa raste, qeveria luan rol kyç për institucionalizimin e strukturave të qytetarëve si komisionet këshillimore të qytetarëve. Përndryshe, qeveritë mund të përdorin edhe mediat dhe publikimet për të garantuar informimin e publikut mbi aktivitetet dhe vendimet e qeverisë. Këto mund të materializohen nëpërmjet organizimit të konferencave të nënpunësve të administratës publike, publikimeve dhe buletineve informative ose dokumenteve të tjera mbi legjislacionin e ri ose të përmirësuar që prek qytetarët sidomos në nivel vendor.

Një nga mjetet më të cilës qytetarët mund të tregojnë impenjimin e tyre të angazhimit qytetar është nëpërmjet pjesëmarrjes në shoqërinë civile ose nëpërmjet *organizatave jo-fitimprurëse* ose lloje të tjera organizatash, si grupet e interesit, grupet me bazë komunitare, shoqatat profesionale etj. Karakteristika unike e OJF-ve qëndron në faktin se ato shërbejnë si pika referimi ku qytetarët mund të ngrenë shqetësimet specifike, sigurisht në një strukturë e cila kombinon një sens aktivizmi qytetar dhe të njohurive të specializuara dhe ekspertizën mbi politikat publike alternative. Nga një tjetër këndvështrim, organizatat jo qeveritare konsiderohen të jenë një mekanizëm nëpërmjet të cilit shoqëria komunikon me qeverinë për të debatuar dhe themeluar së bashku politikat publike.

Sfida kryesore përkon me mënyrat se si aktorët e sipërpërmendur të ndërveprojnë dhe komunikojnë me njëri-tjetrin për të kontribuar kolektivisht në zhvillimin e një procesi efektiv politikash. Komunikimi përbën sfidën më të madhe gjatë ndërveprimit të qeverisë me qytetarët. Kjo sfidë ekziston sepse shpesh të dyja palët nuk kuptojnë siç duhet pozicionet, detyrimet dhe përgjegjësitë e njëri-tjetrit. Ndërveprimi dhe komunikimi efektiv midis të gjithë këtyre aktorëve kërkon jo vetëm një njohje të qartë të roleve reciproke; mbi të gjitha kërkon shfaqjen e vlerave si

respekti, toleranca dhe vullneti për të sheshuar diferencat për të mirën e politikave publike të bazuara në konsensus midis qeverisë dhe publikut.


Përveç ndërveprimit dhe komunikimit, sfida të tjera që pengojnë një ndërveprim të frytshëm midis qeverisë dhe qytetarëve ka të bëjë jo vetëm me mungesën e traditave por edhe me faktorë ekonomikë dhe socialë që përbëjnë bazën e diferencave të mëdha midis pjesëmarrjes së qytetarëve dhe aktivizimit politik përkatësisht në vendet e zhvilluara dhe më pak të zhvilluara. Ndërkohë që pjesëmarrja politike ka të bëjë kryesisht me burimet, besimin dhe mungesën e masave ligjore, pjesëmarrja qytetare është e lidhur ngushtë me zhvillimet socio-ekonomike të një vendi dhe egzistencën e një mjedisi ligjor të favorshëm¹¹.

Globalizimi, ardhja e teknologjive të reja (si qeverisja elektronike) në pjesëmarrjen e qytetarëve, të lidhura këto me shqetësimet mbi mbrojtjen e të drejtave të privatësisë si dhe të ndërvartësisë së proceseve vendimarrëse, që kërkojnë një harmonizim më efektiv të politikave lokale dhe kombëtare me politikëbërjen në nivel ndërkombëtar (si rasti i përfshirjes së qytetarëve në iniciativa globale anti-terrorizëm), aktualisht parashtrojnë sfida të rëndësishme në lidhje me debatin mbi marrëdhënien e pjesëmarrjes së publikut dhe politikave. Sfidat që mbështesin të ardhmen e zbatimit të suksesshëm të koncepteve dhe praktikave të lidhura me pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje kanë të bëjnë me faktin që, ndërkohë që marrëdhënia qeveri-qytetarë i është nënshtruar transformimeve gjatë dekadës së fundit, kjo ka të ngjarë të pësojë një ndryshim akoma më të madh në dekadën tjetër¹².

IV. Procesi i Politikave dhe Pjesëmarrja e Qytetarëve

Përveç faktit përgjithësisht të njohur që qytetarët nuk preken në mënyrë të barabartë nga politikëbërja kombëtare, është e diskutueshme nëse ata preken më tepër nga politikat kombëtare sesa ato të bëra në nivel lokal, duke patur parasysh që ata ndërveprojnë më tepër me qeverisjen vendore. Cilido qoftë ndikimi i marrëdhënieve ndërqeveritare tek qytetarët, politikëbërja bazohet në një proces standart që ndjek një cikël të pranuar përgjithësisht. Nga një pikëpamje teknike, ndërveprimi midis çdo niveli të qeverisë me qytetarët ilustron në skicën e mëposhtme:

Skica 1
(Lokal) Ndërveprimi Qeveri-Qytetar në
Procesin e Zhvillimit të Politikave Publike




¹¹ Fioramonti, L. & Heinrich, V. Finn, 2007

¹² Cady J. & Vergez, C., 2001

Siç u përmend më lart, qytetarët mund të marrin pjesë në politikëbërjen e qeverisë me disa mënyra. Megjithatë, procesi i politikave përbëhet zakonisht nga komponentët e mëposhtëm: hartim i axhendës, analizë informacioni dhe konsultim, debat mbi politikën dhe formulim, vendim-marrje, krijim i politikës, implementim i politikës, monitorim dhe vlerësim. Figura 1 më poshtë tregon me hollësi, në një renditje kronologjike, secilën nga fazat e politikëbërjes duke ofruar një përkufizim të gjerë të aktiviteteve në çdo fazë.

Figurë 1



E rëndësishme për tu theksuar është se nga të shtatë fazat e mësipërme, faza në të cilën nocioni i pjesëmarrjes së qytetarëve në politikëbërje është shqetësues lidhet me “hapin e informimit dhe konsultimit”. Ndërkohë që kjo mund të përfshijë: mbledhjen e fakteve dhe njohurish nga një sërë burimesh duke përfshirë qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile, kuptimin e kontekstit përfshirë dhe pasojën për zyrat e axhendës, një dallim ky që duhet shtruar midis *informimit dhe konsultimit* nga njëra anë dhe *pjesëmarrjes aktive të qytetarëve* nga ana tjetër.

Informimi dhe konsultimi përfaqësojnë përkatësisht një marrëdhënie një drejtimëshe dhe dy drejtimëshe, në të cilat qeveria ose mënjanohet ose merr informacione dhe reagim nga publiku. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve nga ana tjetër është një marrëdhënie e cila bazohet në partneritet me qeverinë në të cilën qytetarët aktivisht përfshihen për të përkufizuar procesin dhe përmbajtjen e politikëbërjes. Ajo njihet rëndësinë e barabartë të qytetarëve në hartimin e

axhendave, duke propozuar alternativa politikash dhe duke formëzuar dialogun politik – edhe pse përgjegjësia për vendimin përfundimtar mbi formulimin e politikave i mbetet qeverisë¹³.

V. *Parimet, Mekanizmat dhe Mjetet*

Parimet udhëheqëse themelore të konceptit të pjesëmarrjes së qytetarëve në çështjet e vendim-marrjes përkundrejt qeverisë si promotori i ideve mbi politikat dhe kapitalit njerëzor, janë të nevojshme për të implementuar këto ide. Prandaj, qeveritë janë nën presionin global për t'u krijuar qytetarëve ambientin e nevojshëm dhe kushtet për të shprehur opinionin e tyre në zhvillimin e politikave publike. Nga ana tjetër, pjesëmarrja aktive kërkohet në mënyrë konstante për të rritur vizibilitetin dhe legjitimitetin e rolit të qeverisë në nxitjen e kontributit të qytetarëve në politikëbërje. Kjo është mënyra se si hartohen me konsensus politikat midis qeverisë dhe publikut. Me fjalë të tjera, disa parime themelore mbi të cilat bazohet pjesëmarrja aktive (ose përfshirja e qytetarëve), përfshin ndarjen e procesit të hartimit të axhendave me të gjithë pjesëmarrësit, një kohë të mjaftueshme për rrahje mendimesh, vënia e theksit mbi ndarjen e vlerave sesa bërje debatësh si dhe praktika konsultimesh të cilat bazohen në gjithëpërfshirje, mirësjellje dhe respekt¹⁴.

Nga një perspektivë globale, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) ka përcaktuar disa nga parimet kyç për të garantuar që pjesëmarrja e qytetarëve në politikëbërje të bëhet në mënyrë të tillë që të kombinohen të drejtat e qytetarëve për t'u informuar nga qeveritë, me rolin e kësaj të fundit për të garantuar që kontributi publik nëpërmjet konsultimeve dhe pjesëmarrjes aktive të çojë në mirëqeverisje në përgjithësi. Disa prej këtyre parimeve kanë të bëjnë me angazhimin nga të gjithë aktorët e përfshirë (qeveria, qytetarët, grupet e interesit etj), njohjen e të drejtës së qytetarëve jo vetëm për të patur akses mbi informacionin por dhe të marrin pjesë aktivisht në politikëbërje, qartësi në përcaktimin e rregullave të ndërveprimit qeveri-qytetarë duke përfshirë objektivat dhe kufizimet për konsultime me qëllim zhvillimin e politikave publike; koha dhe burimet e nevojshme për institucionalizimin e pjesëmarrjes publike në zhvillimin e politikave; koordinimin midis njësive qeverisëse dhe qytetarëve për të garantuar që konsultimet dhe kontributi i publikut të jenë kuptimplota dhe efektive; përgjegjshmëri nga ana e qeverisë për të siguruar që procesi i politikëbërjes të jetë transparent dhe i hapur jo vetëm për kontrollin publik por edhe për vlerësim. Një tjetër parim udhëheqës kyç për pjesëmarrje efektive qytetare në zhvillimin e politikave është pjesëmarrja aktive drejt një ndarje të informacionit ose konsultimet publike.

Për çdo aktor dhe grup interesi të përfshirë në procesin e politikëbërjes qofshin qeveritare, jo-qeveritare apo nga sektori publik, do të përbënte një sfidë për të treguar angazhimin e tyre për të pasqyruar parimet udhëheqëse të sipërpërmendura pa mekanizmat e nevojshëm. Më hollësisht, këto mekanizma përfshijnë *legjislacionin*, *politikat* dhe *institucionet* tërësia e të cilave ka nevojë të lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe transparente me politikëbërësit nëpërmjet bashkëpunimit, plotësimit dhe bashkëpunimit¹⁵. Të gjithë këta aktorë përgjegjës për t'u konsultuar dhe për të dhënë kontribut mbi politikat – një rrethanë, e cila ndryshon në vartësi të qëndrimeve, aftësive, stimujve midis zyrtarëve publike, shtrirja e lirive

¹³ Caddy, J. & Vergez, C., 2001

¹⁴ Edgar L., Marshall C. and Bassett M, 2006

¹⁵ Coston, J., 1998

civile dhe politike, historia lokale dhe marrëdhëniet e pushtetit midis vendeve të ndryshme – janë të gjithë të rëndësishëm për mënyrën se si politikat implementohen¹⁶.

Mjetet për pjesëmarrjen qytetare janë të nevojshme për të mbështetur aksesin e qytetarëve mbi informacionin sipas kërkesave (dhënie pasive informacioni) dhe përpjekjet e qeverisë për të shpërndarë informacion (dhënie aktive informacioni). Zgjedhja e përfaqësive dhe mjeteve në dispozicion do të varet nga objektivat, burimet financiare dhe kapacitetet njerëzore të njësisë së qeverisë së interesuar¹⁷. Këto mjete mund të përfaqësojnë produkte të thjeshta informuese ose forume të fokusuara për të përfshirë qytetarët në politikëbërje. Disa prej këtyre mjeteve, produkte informuese ose forume janë:

- *Raporte vjetore*, të cilat qeveritë mund t'i publikojnë në përpjekje për të ndarë informacionin me grupe interesi mbi politikat përfshirë këtu qytetarët, OJF-të, komunitetin dhe grupet e interesit që kanë të bëjnë me veprimet e qeverisë në përpjekje për të monitoruar dhe vlerësuar performancën e tyre.
- *Broshura, udhëzues, manual dhe fletëpalosje*. Në rastin e qeverisjes vendore këto produkte mund të konsistojnë në publikime që rendisin funksionet themelore të bashkive, të zyrtarëve të zgjedhur dhe numrat e telefonave për shërbime të veçanta. Në rastin e OJF-ve, këto produkte mund të përfshijnë një listë me qëllimet dhe projektet e tyre. Ndërkohë që broshurat mund të përgatiten për audienca të veçanta dhe mund të jenë broshura turistike, udhëzues zhvillimi ekonomik, etj.
- *Katalogë, indekse, rregjistra*, të cilat lejojnë qytetarët të identifikojnë dhe përcaktojnë vendndodhjen e informacionit të prodhuar nga njësitë e administratës publike¹⁸.
- *Korrespondencë direkte* e cila konsiston në letra mbi politikat, fletëpalosje, broshura etj, që u shpërndahen qytetarëve me anë të postës.
- *Qendra informuese*, mund të konsistojnë në komplekse zyrash publike që ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh informative, ose 'one-stop shop' ku qytetarët mund të adresojnë pyetjet, komentet dhe/ose ankesat e tyre mbi një politikë publike të caktuar.
- *Shërbimet Telefonike*. Njësitë e administratës publike përdorin numra telefonikë automatikë ose 'call centres' ku qytetarët mund të telefonojnë për pyetje, komente dhe/ose ankesa mbi një politikë publike të caktuar.
- *Fjalimet publike* me të gjitha tipet e audiencës dhe zgjedhësve të zonave elektorale janë një mundësi e mirë dhe një mjet i përbashkët për të komunikuar me publikun mbi çështje politikash. Zyrtarët e administratës publike duhet të jenë të arritshëm në mënyrë të tillë që të dinë se cilat janë shqetësimet e qytetarëve dhe të komunikojnë drejtpërsëdrejti me ta; fjalimet publike përfaqësojnë një mjet efektiv për të adresuar këtë nevojë.

¹⁶ Kingdon, J.W., 1984

¹⁷ Caddy, J. & Vergez C., 2001

¹⁸ Caddy, J. & Vergez C., 2001

- *Ngjarje publike dhe të veçanta.* Disa forma të ngjarjeve publike dhe të veçanta (panaire, ekspozita, seanca ‘pyetje & përgjigje’) kanë provuar të jenë një ambient i dobishëm ku të jepen shpjegime mbi aktivitetet e qeverisë duke i përfshirë kështu qytetarët në politikëbërjen publike.
- *Mediat, të shkruar dhe elektronike,* TV dhe radio konsiderohen tepër tradicionale por mjete shumë të fuqishme informacioni për qytetarët (nëpërmjet konferencave, debateve publike, deklarata për shtyp) duke marrë parasysh përpjekjet e qeverisë jo vetëm për ta informuar publikun por dhe për ta përfshirë në procesin politikëbërës.
- *Sondazhet mbi opinion publik/anketimet* janë shumë të vlefshme për të matur opinionin publik dhe/ose qëndrime. Shpesh, perceptimi publik është i ndryshëm me perceptimin e qeverisë ose organizatave. Qeveria mund të mësojë nëpërmjet sondazheve dhe anketimeve që ata dhe publiku nuk ndajnë të njëjtin mendim mbi një çështje politikash.
- *Dëgjesat publike ose seancat publike* përfaqësojnë takime të hapura ku njësitë e administratës publike prezantojnë legjislacionin e ri, propozime politikash ose plane mbi shpërndarjen e buxhetit, duke u përpjekur të krijojnë një ambient ku qytetarët të ndihen të lirë për të dhënë kontributin e tyre dhe të ndajnë këndvështrimin dhe/ose shqetësime mbi çështje specifike politikash.
- *Udhëzimet publike,* ndryshe nga takimet publike, janë një lloj takimi ku prezantuesit ofrojnë një shpjegim të shkurtër ose materiale politikash të një çështjeje një audiencë të caktuar. Këto janë më pak formale dhe mbahen në një konferencë për shtyp dhe takimeve publike.
- *Forumet e Tri-partiteve,* të cilat përfaqësojnë një forum publik me pjesëmarrjen e agjensive qeverisëse, shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të bizneseve të mbledhur për të diskutuar mbi alternativa politikash publike.
- *Grupe të fokusuara* lejojnë mbledhjen e komenteve dhe sygjërimeve nga përfaqësues të grupeve të targetuara me interesa specifike në një propozim politikash ose vendim.
- *Forume qytetare dhe Juritë*¹⁹. Të parët ofrojnë mjete për të shpërndarë propozime politikash të prodhuara nga qytetarët ose organizatat, përfaqësuese të tyre drejtëpërsëdrejti politikëbërësve kurse e dyta përfaqëson një grup qytetarësh të cilët marrin në pyetje opinionin e ekspertëve mbi fusha të caktuara politikash.
- *Panelet qytetare** përfaqësojnë një grup të qëndrueshëm përfaqësuesish nga një grup i targetuar (përshebull të rinj) të cilët konsultohen rregullisht nga qeveria mbi çështje politikash të ndryshme²⁰.

¹⁹ Caddy J. & Vergez C., 2001

²⁰ Caddy J. & Vergez C., 2001

- *TIK (lista email-esh, biseda mbi ngjarje online, forume diskutimesh online, etc.)* ofrojnë mundësi të reja për qeverinë, për të marrë kontributin dhe konsultime me individët drejtpërsëdrejti gjatë politikëbërjes – pa ndërmjetësimin e politikanëve e zgjedhur ose organizatave të shoqërisë civile.

VI. Impakti i pjesëmarrjes së qytetarëve në politikat: Të dhëna dhe statistika

Seksioni i mëposhtëm ‘Praktikat më të mira’ (në lidhje me pjesëmarrjen qytetare për politikëbërjen) do të përshkruajë shumëllojshmërinë e mënyrave me anë të të cilave mekanizma të ndryshëm, duke përfshirë dhe agjensi qeveritare, organizata jo-fitimprurëse, grupe interesi etj, mund të promovojnë pjesëmarrjen qytetare në politikëbërje. Këtë ndikim të drejtëpërdrejtë (ose indirekt) nuk e kanë vetëm institucionet por mbi të gjitha spektri i mjeteve të komunikimit në masë dhe mjeteve që bëjnë të mundur që konceptet e lidhura me promovimin e përfshirjes qytetare në zhvillimin e politikave të studiohet dhe analizohet. Kjo shumëllojshmëri përfshin produkte informacioni (postime, fletëpalosje, njoftime publike, etj), struktura formale për marrëdhënien qeveri-qytetarë (panelet qytetare, komitete këshilluese, etj) ose mjete më demokratike dhe moderne për mirëqeverisje (pjesëmarrje në shpërndarjen e buxhetit, etj).

Aspekti më interesant i kërkimeve dhe analizave mbi përfshirjen qytetare në politikëbërje është ndikimi i ambientit social, politik dhe historik në zhvillimin e shoqërisë civile, e si rrjedhojë dhe e zhvillimit dhe përparimit të përfshirjes qytetare në bazë të fushave të politikave në pjesë të ndryshme të botës. Gjithashtu, diversiteti i pafund i formave të aktivizmit qytetar (dhe ndikimi i tyre mbi politikat), për pjesën më të madhe reflekton shumëllojshmërinë e konteksteve, tendencat aktuale dhe sfidat e së ardhmes. Për shembull, analiza e shoqërive civile në Amerikën Latine, të cilat janë shumë të politizuara dhe kundërshtuese, portretizon një realitet krejtësisht të ndryshëm nga vlerësimi i shoqërive civile Europiane “në njëfarë mënyre për një marrëdhënie të rehatshme me shtetin”. Në mënyrë të ngjashme, zhvillimi i shpejtë socio-ekonomik dhe rritja e pabarazisë sociale përkufizon dhe sfidat aktuale të shoqërisë civile në zonën e Azisë-Paqësorit, ndërkohë që në pjesën më të madhe të rajoneve, shoqëritë civile përballen me varfëri në rritje ose të përhershme (Afrika Nën-Sahariane) ose me dobësimin e shtetit social (Europa Jugore dhe Perëndimore)²¹.

Për të vërtetuar sa më sipër, ky dokument përdor një analizë të dhënash sipas fushës së politikave – të drejtat e njeriut, politikat sociale dhe buxheti kombëtar – të udhëhequra nga CIVICUS Global Survey mbi gjendjen e shoqërisë civile (2007), e cila tregon se ndikimi i shoqërisë civile jo vetëm ndryshon nga vendi në vend por dhe nga sektori i politikave (Tabela 1):

Tabla 1. Impakti i Politikave nga Rajonet e Botës dhe Fushat e Politikave

Rajoni	Të Drejtat e Njeriut	Politika Sociale	Buxheti Kombëtar %
Amerika Latine	2.1	1.9	1.0
Europa Perëndimore dhe Jugore	2.4	2.4	1.2
Europa Post-komuniste	1.8	1.7	0.8

* Në ndryshim me ‘Panelet Qytetare’, janë Komitetet këshilluese, të cilat përbehen nga një grup përfaqësues i një interesi të caktuar dhe përzgjidhen nga qeveria për të sjellë kontribute në zhvillimin e politikave duke bashkëvepruar me zonat elektorale që ata përfaqësojnë

²¹ Fioramonti, L. & Heinrich, V. Finn, 2007

Afrika Nën-Sahariane	1.5	1.7	1.2
Azia	1.9	1.6	1.2
Mesdheu dhe Lindja e Mesme	1.6	1.4	0.8
<i>Mesatare</i>	<i>1.9</i>	<i>1.7</i>	<i>1.0</i>

VII. Praktikak më të Mira dhe Modele

Raportet e ndryshme analitike e vlerësojnë situatën e shoqërisë civile në vende dhe rajone të ndryshme, bazuar në pjesëmarrjen e tyre në politikat vendim-marrëse. Dinamikat që karakterizojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në realizimin e politikave në vendet e Evropës Qëndrore dhe Lindore, në një masë të madhe ka të bëjë me zhvillimet historike të shoqërisë civile në Evropën post-komuniste dhe sfidat që lidhen me trashëgimitë nga e kaluara komuniste, vështirësitë e tranzicionit drejt konsolidimit të demokracisë si dhe marrëdhëniet e dobëta me sektorin privat.

Ndonëse, duke ju referuar statistikave, mund të gjejmë përjashtime midis vendeve të Evropës Qëndrore dhe Lindore përsa i përket angazhimit në politikat vendim-marrëse (p.sh rasti i Republikës Çeke dhe Sllovenisë), është ndoshta më mirë nëse referencat bëhen gjithashtu me rajone të tjera dhe vende specifike, të cilat japin eksperiencat më të vlefshme në angazhimin e shoqërisë civile në vendim-marrjet e qeverise si dhe në realizimin e politikave publike.

Bazuar në analizën e hollësishëm të literaturave, ky studim nxjerr në pah disa nga praktikak më të mira në lidhje me pjesëmarrjen e qytetarëve në politikë, e analizuar kjo në perspektiva të ndryshme dhe e ilustruar nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, pjesa më e madhe e të cilave është diskutuar teorikisht si më poshtë që i referohet pjesës “Pjesëmarrja qytetare: Mekanizma dhe instrumente”.

E drejta e qytetarëve për t’u informuar dhe edukuar është thelbësore në raportin e pjesëmarrjes civile dhe realizimin e politikave. **Kanadaja** për shembull, është e njohur për përpjekjet sistematike institucionale për të siguruar pjesëmarrjen e gjerë civile në politikat vendim-marrëse.

Departamenti i Shëndetësisë i *Qeverisë Kanadeze*, për shembull, ka publikuar një manual që referohet si “*Instrumentat politikë për pjesëmarrjen publike në vendim-marrje*”. Manuali vendos politikat e Departamentit dhe përcakton (pesë) nivelet e pjesëmarrjes në termat e objektivave gjithëpërfshirëse: të informojë, të mbledhë informacion, të diskutojë, të angazhohet dhe të mbështesë partneritetin. Për secilin nivel janë ofruar një strukturë teknikash dhe një studim i veçantë për të ilustruar përdorimin e tyre në praktikë. Secila teknikë është e përshkruar në termat e aplikimit, kostos dhe limitet²².

Në disa raste, aktivizmi i shoqërisë civile demonstron në vetvete në formën e aktivizmit socio-politik dhe karakterizohet nga bashkëpunimi, i cili ka një ndikim të drejtëpërdrejtë në politikat vendim-marrëse. I tillë është rasti i **Koresë së Jugut**.

²² Caddy, J. and Vergez C., 2001

Në **Korenë e Jugut** organizatat advokatore gëzojnë një bashkëveprim të rregullt me institucionet shtetërore. Në të njëjtën kohë ato arrijnë të kenë ndikim në vendim-marrjet politike si dhe të sigurojnë përgjegjshmërinë e qeverisë. Shpesh, grupet e shoqërisë civile bashkohen për të mbrojtur interesat e përbashkëta në çështjet sociale e politike, si përshembull lëvizja 'Nakseon' në vitin 2000, e cila rrëzoi kandidatët e korruptuar nga zgjedhjet elektorale²³. Organizatat e shoqërisë civile në Korenë e Jugut kanë tendencën për të vënë në përdorim strategji solidariteti në realizimin e axhendave dhe mobilizimit politik nëpërmjet fushatave, peticioneve, bojkoteve dhe demonstratave, me qëllim advokacinë ndaj çështjeve sociale e politike.

Ndërkohë modelet amerikane nënvizojnë forma më institucionale të pjesëmarrjes qytetare me ndikim direkt në përpilimin e politikave publike.

Takimet publike të këshillit të qytetit, interperlanca publike, sidomos përsa i përket buxhetit, janë disa nga format e ndryshme që këshillet e qyteteve në ShBA mund të inkorporojnë në axhendat e tyre formale për të institucionalizuar pjesëmarrjen publike. Shumë këshille të qytetit lënë mënjanë kohë të mjaftueshme në axhendën e tyre për publikun, për t'ju adresuar drejtpërdrejt këshillit. Këshillet e qytetit gjithashtu mund të zhvillojnë seanca dëgjimore si pjesë e axhendës së punës, me qëllim mbledhjen e fakteve dhe opinioneve përsa i përket legjislacionit të propozuar, të vlerësojnë opinionin e publikut, si dhe të mundësojnë mbulimin e një çështjeje të caktuar në media.

Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, gjejnë rrugë të hapura në shumë vende perëndimore, ku interneti po përdoret si mënyrë efektive për të lidhur publikun me qeverinë dhe të sigurojë angazhimin e publikut në politikat vendim-marrëse. Përshembull:

*Në **Britaninë e Madhe**, qeveria ka krijuar një portal në internet i dizenuar për të shërbyer si një burim potencial kyç për bashkëveprimin qytetar – qeveri dhe qytetar – qytetar. Kjo i referohet të ashtëquajturës "Hapësira qytetare" dhe qëllimi kryesor i saj është për të siguruar një pikë ndërlidhëse në konsultimin e qeverisë, lehtësimin e diskutimeve publike në çështjet politike, ofrimin e informacionit të nevojshëm politik dhe qytetar që mund të ndihmojë qytetarët për tu njohur me çështjet politike të qeverisë si dhe për të krijuar hapësirën e nevojshme për qeverinë elektronike (online).*

Në të tjera raste, efekti i pjesëmarrjes qytetare në vendim-marrjet politike është i lidhur ngushtë me kapacitetet e brendshme të shoqërisë civile dhe një klimë bashkëpunimi i marrëdhënieve mes shoqërisë civile dhe qeverisë:

*Rasti i **Ganës** shënon një model të mirë. Duke iu referuar informacionit dhe komenteve të mbledhura nga 'Monitorimi global i gjendjes së shoqërisë civile'*

²³ Heinrich, V. Finn, 2007

bazuar në Indeksin e Shoqërisë Civile, veçohet se shoqëria civile në Gana, relativisht ka një ndikim të lartë në politikat publike si rrjedhojë e ekzistencës së një rrjeti profesional të shoqërisë civile me aftësi domethënëse dhe kapacitete të mjaftueshme në angazhimin politik si dhe deri diku ekzistenca e një qeverie të hapur, bashkëpunimi i së cilës ka kontribuar në një masë të madhe në zhvillimin ekonomik dhe social të një target grupi të caktuar: atyre të grave.

Realizimi i buxhetit në mënyrë gjithëpërfshirëse është një tjetër pikë e vlefshme për tu diskutuar, ku pjesëmarrja e qytetarëve në formulimin e politikave është më së miri i demonstruar dhe materializuar. Në Medellin, **Kolumbia (SHBA)**, përshembull, Këshilli Komunal Konsultativ (KKK), si një pjesë kryesore e procesit të pjesëmarrjes në realizimin e buxhetit, konsiston në një pikë takimi të reflektimit qytetar në zhvillimet lokale. Kjo shënon një hapësirë njohjeje për të arritur vendime dhe marrëveshje mes qeverisjes vendore dhe komuniteteve lokale.

KKK në Medellin, Kolumbia, siguroi pjesëmarrjen e më shumë se 1484 organizata pjesëmarrëse në diskutimet e përcaktimit të buxhetit dhe u karakterizua nga një prezencë e lartë e kapitalit social. Kjo strategji në Medellin, është ndërtuar në kornizat e një politike gjenerale e cila synon të identifikojë dhe përdorë të gjitha burimet në dobi të komuniteteve të varfëra e të mbështesë pjesëmarrjen e tyre politike në zhvillimin e qytetit. Kjo praktikë përfshin shpërndarjen e burimeve për secilin komunitet bazuar në llogaritjet e “Indeksit të Zhvillimit Njerëzor” si dhe të numrit të banorëve për secilin komunitet. Arritja më e madhe ishte që nëpërmjet planifikimit gjithëpërfshirës dhe planifikimit të kujdesshëm financiar, qytetarët kanë fituar më tepër besim përsa i përket kapaciteteve të tyre pa ju nënshtruar intrigave politike²⁴.

Në të njëjtën kohë ekzistojnë raste sporadike kur organizata të ndryshme nga shoqëria civile, ndonëse tradicionalisht përqëndrohen në rolin e tyre si sigures të mirëqënies, po i shmangen këtij roli dhe si pasojë po bëhen gjithmonë e më aktive në fushën e advokacisë dhe mobilizimit të qytetarëve siç është rasti i **Hong Kongut** që përshkruhet më poshtë:

‘Indeksi i Shoqërisë Civile’ zbulon se shoqëria civile në Hong Kong ka një ndikim të madh në shoqëri. Në veçanti, më domethënës është roli që ato luajnë në masat e ndërmarrja në kuadër të shërbimeve sociale. Edhe pse kjo traditë vazhdon edhe sot, mjaft organizata nga shoqëria civile (OShC), kohët e fundit kanë ndërmarrë të tjera role, në veçanti përsa i përket formimit të axhendës publike dhe sfidimit të politikave publike. Aftësia e OShC-ve për të influencuar politikat publike ka qenë e suksesshme në fusha të ndryshme si psh politikat e të drejtave të njeriut. Më 1 Korrik 2001, në mbështetje të pakënaqësive që legjislacioni anti-terrorizëm kishte shkaktuar tek qytetarët pasi cënonte seriozisht liritë civile, OShC-të mblodhën më tepër se gjysëm milionë njerëz për të protestuar në lidhje me këto politika. Si pasojë, implementimi i këtij ligji u shty nga qeveria, dhe më pas arriti të rrëzohet²⁵.

²⁴ LogoLink International Workshop on Resources: Citizen Engagement and Democratic Local Governance, Porto Alegre, Brazil, 6-9 December 2004

²⁵ Heinrich, V. Finn, 2007

Në të tjera raste OShC-të janë struktura ndërmjetësuese të ngjashme me ‘Ndërlidhësin Komunitar’ i konceptuar dhe i lançuar nga IDM (i detajuar më poshtë në rastin studimor), i cili siguron jo vetëm zgjidhjet e konflikteve mes qeverisë dhe publikut, por edhe kontributin e publikut në reformat e politikave qeveritare:

Një shembull i mirë është roli i “Ndërmjetësit të Republikës” në konceptin francez të “Kontrollit Institucional”²⁶. Bazuar në këtë praktikë ‘Ndërmjetësi i Republikës’ ka qenë e është përgjegjës që nga viti 1973, për gjetjen e marrëveshjeve jashtë gjykatave, të konflikteve mes qytetarëve dhe administratës në përgjithësi. Megjithatë (edhe pse) Ndërmjetësi nuk mund të veprojë nëse çështja është paraqitur përpara gjykatës, ose nëse ankesa ka të bëjë me një mosmarrëveshje midis administratës dhe një zyrtari publik, ai formulon dhe dorëzon propozime për reforma autoriteteve publike, dhe rrjedhimisht duke kontribuar në përmirësimin e marrëdhënieve mes qeverisë dhe qytetarëve.

Disa segmente të shoqërisë civile si unionet tregtare, dhe shoqatat profesionale në **Republikën Çeke**, mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në politikat vendim-marrëse në fusha të ndryshme falë aftësive të tyre për të forcuar marrëdhëniet miqësore me institucionet qeveritare:

Organizatat e Shoqërisë civile në Republikën Çeke luajnë një rol vital përse i përket ndikimit të tyre në politikat publike dhe angazhimi i tyre me qeverinë në lidhje me çështjet politike. Përfundimet e OShC-të identifikojnë në veçanti dy fusha të rëndësishme të ndikimit politik të OShC-ve, të emëruara: mbrojtja ambjentale dhe shërbimi social. OShC-të që punojnë me këto çështje ia kanë dalë mbanë për të futur kërkesat e tyre në axhendën publike siç ka ndodhur me ‘Aktin e Shërbimeve Sociale’. Krahas kësaj, unionet tregtare dhe shoqatat profesionale dhe ekonomike, tradicionalisht janë aktive dhe të suksesshme duke influencuar politikat publike në nivel kombëtar. Shoqëria civile ja detyron më së shumti suksesin e saj në ndikimin që ka në politikat publike, përgjithësisht marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunuese me qeverinë²⁷.

XIII. Rast Studimor: Përprjekjet e bëra nga IDN -Shqipëri

Si një ‘Think Tank’, IDN është e vendosur në promovimin e pjesëmarrjes qytetare në proceset vendim-marrëse në nivelin lokal dhe në mënyrë të vazhdueshme në rritjen e përgjegjshmërisë të aktorëve vendim-marrës në nivel lokal nëpërmjet përqasjes poshtë-lartë/lart-poshtë. IDN ka punuar gjithmonë me organizmat e qeverisë vendore në forcimin e kapaciteteve komunikuese me komunitetet si dhe me strukturat qytetare me qëllim rritjen e vetëdijes përse i përket rolit të tyre si aktorë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë.

IDN, një pioner i hershëm në nxitjen dhe institucionalizimin e strukturave ndërmjetësuese dhe mekanizmave të organizimit social siç janë “ndërlidhësi komunitar” dhe “grupet e bazuara në komunitet”, beson plotësisht se nuk mund të arrihet asnjë progres konkret pa një perspektivë të plotë dhe të konsoliduar që merr parasysh përfshirjen aktive të qytetarëve në përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet, kuptueshmërinë dhe përvetësimin kulturor të përgjegjësive

²⁶ Caddy J. and Vergez, C., 2001

²⁷ Heinrich, V. Finn, 2007

qytetare, fuqizimin e zbatimit të ligjit nëpërmjet partneritetit me komunitetin, luftën ndaj korrupsionit si një përgjegjësi morale shoqërore, forcimi i përgjegjshmërisë si një nevojë qytetare, nisma për të promovuar bashkëpunimin me sektorët privat dhe publik me grupet qytetare, zhvillimin e mëtejshëm të profileve sociale tek bizneset private, zhvillimin më të gjerë të rrjeteve të strukturave ndërlidhëse etj. Realizimi i suksesshem i këtyre strukturave do të mundësonte që qytetarët të ndihen pjesmarrës të aftë dhe aktiv në proceset demokratike. Në të vërtetë strukturat e lartpërmendura shërbejnë jo vetëm për të lehtësuar komunikimin ndërmjet komuniteteve, qeverisë lokale, biznesit dhe grupeve të ndryshme të interesit, por në të njëjtën kohë mendohet se janë esenciale në shoqëritë multi-etnike, ku struktura të tilla mund të ndihmojnë për të reduktuar konfliktet e brendshme dhe sigurojnë fuqizimin dhe zbatimin e ligjit.

Rasti studimor i mëposhtëm nënvizon disa nga arritjet dhe sfidat më domethënëse të ndërmarra nga IDN:

E promovuar nga IDN, struktura e *Ndërlidhësit Komunitar* është një model i qëndrueshëm që përfshin qytetarët në procesin e krijimit të axhendës në politikat vendim-marrëse. Kjo strukturë bazohet në modelin tipik të praktikës shqiptare dhe është duke operuar në qytetet e Shkodrës, Tiranës, Durrësit. Prej më shumë se një viti, ideja për rolin e Ndërlidhësit Komunitar në demokracitë vendore, ka qenë mjaft e rëndësishme në objektivat e IDN, me qëllim rritjen e ndërgjegjes dhe në të njëjtën kohë integrimi i vëmendjes së të gjithë vendim-marrësve në nivel lokal dhe kombëtar në rivlerësimin dhe ridimensionimin e këtyre strukturave. Këto struktura synojnë të përgatisin përballimin e sfidave të reja të realitetit shqiptar në nivel lokal. Përpjekjet e IDN-së mbi mobilizimin lokal dhe decentralizimin në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme²⁸ po mbështesin qeveritë lokale në të gjithë Shqipërinë për të institucionalizuar këtë strukturë që si e tillë do të qëndrojë si ndërmjetës mes qytetarëve dhe strukturave lokale ku siç u përmend synohet mobilizimi dhe organizimi i komunitetit, zhvillimi i partneritetit lokal dhe stimulimi i bashkëveprimit dinamik.

Në princip struktura e *Ndërlidhësit Komunitar* nuk zëvendëson institucione të tjera. IDN inkurajon të gjithë partnerët lokalë të konsiderojnë këtë strukturë si një lehtësues, promovues, mbështetës, informues dhe orientues të politikave vendore. Duke e parë këtë strukturë si të tillë, ajo do të mund të përmirësojë implementimin e të gjitha komponentëve të parashikuara nga ligji organik i qeverisjes lokale ose i institucioneve të tjera dhe të lidhura me angazhimin dhe mbështetjen e komunitetit. Mbi të gjitha roli i Ndërlidhësit Komunitar është që të përfaqësojë zërin e komunitetit në procesin e marrjes së vendimeve politike në nivelin lokal, përmirësimin e komunikimit reciprok midis strukturave të qeverisjes vendore dhe komunitetit përkatës, organizimin e komunitetit në marrjen e përgjegjësisë qytetare dhe zhvillimin e partneriteteve me institucione të tjera të interesuara në forcimin e ligjit në nivel lokal.

Nëpërmjet kontributit të vlefshëm të Ndërlidhësive Komunitar ekzistues²⁹, IDN-ja ka qenë e aftë të promovojë me sukses eksperiencën e saj në mobilizimin e komunitetit në qytetet e Shkodrës duke themeluar Grupe të Bazuara në Komunitet dhe operimin e tyre në praktikë nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme. Tani që në Shkodër ka një eksperiencë të konsoliduar përsa i

²⁸ On this purpose, IDM's Executive Director and the Deputy Minister of Interior have signed a joint letter which guides local government representatives to include the CL position on their structures, as a useful and efficient means for local democracy.

²⁹ 22 Community Liaisons in Total

përket mobilizimit të komunitetit dhe pjesëmarrjen qytetare, struktura e Ndërlidhësit Komunitar duhet të ridimensionohet me qëllim për tju përshtatur dhe përballuar sfidave të reja në zhvillimet e demokracisë komunitare. Bazuar në infrastrukturën e përmirësuar të bashkëpunimit mes strukturave lokale dhe komunitetit në Shkodër, dhe njohja e mirë e pozicionit të Ndërlidhësit Komunitar në qytet, IDN-ja ka si qëllim të ndërtojë kapacitetet e kësaj strukture nëpërmjet transformimit të saj në një strukturë nevralgjike që lidh qytetarët me qeverinë e tyre.

Ky model në të cilin veçohet bashkëpunimi substancial i Bashkisë është prezantuar me sukses në qytetin e Durrësit, ku kjo strukturë mungonte totalisht. Kjo iniciativë e ndërmarrë në Durrës mund të quhej sfiduese, duke marrë parasysh se struktura e Ndërlidhësit Komunitar, ndonëse e parashikuar me ligj, nuk ishte themeluar asnjëherë më parë. Kështu, përpjekjet e IDN-së u përqëndruan që nga fillimi i këtij projekti, në krijimin e nje procesi selektimi në kritere transparente dhe të hapura të Ndërlidhësit Komunitar. Kjo konsiston në një procedurë që së pari do të mund të arrijë konsensusin e përbashkët të publikut për zgjedhjen e kësaj strukture, dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak për emërimin e tyre. Aktualisht në Bashkinë Durrës operojnë gjashtë Ndërlidhës Komunitar, me një buxhet të veçantë nga Bashkia drejtuar themelimit dhe funksionimit të kësaj strukture. Aktualisht Ndërlidhësit Komunitar po marrin asistencë teknike dhe trajnime nga IDN-ja, mbi përfaqeset më të mira në bashkëveprimin me komunitetin si dhe në të njëjtën kohë me aktorët privatë dhe publikë që operojnë në qytetin e Durrësit.

Praktika më e mirë e marrë në Durrës mendohet të transferohet shumë shpejt në kryeqytet, Bashkinë e Tiranës, së bashku me 11 njësitë bashkiake që ajo mbulon. Tirana ka një strukturë të Ndërlidhësit Komunitar³⁰ që në vitin 1994 ndonëse me shumë probleme dhe mungesë të theksuar eksperience për shumicën e personave që menaxhojnë dhe implementojnë këtë strukturë. Bashkia e Tiranës është bashkia më e madhe në Shqipëri dhe organizimi dhe funksionimi i saj bazohet në një ligj specifik. Ajo është e ndarë në 11 njësi bashkiake që mbulojnë të gjithë popullsinë e kryeqytetit. (çdo njësi bashkiake siguron shërbime për një popullësi që varion nga 60.000 në 100.000 banorë). Të 11 njësitë bashkiake kanë krijuar komunitetet përkatëse secila e përfaqësuar me një kryetar. Me qëllim për të ndërtuar ura komunikimi mes administratës dhe qytetarëve, Bashkia e Tiranës ka aprovuar që nga viti 1994 një vendim që i njuh të drejtën çdo Kryetari të Njësisë Bashkiake për të punësuar me kohë të pjesshme Ndërlidhës Komunitar të cilët do marrin një honorar mujor për shërbimet që realizojnë. Numri i përgjithshëm i Ndërlidhësave Komunitar në Tiranë është 222 punonjës, dhe ka një kërkesë konstante nga Shoqata e Njësisve Bashkiake të bindin Këshillin Bashkiak të Tiranës që të miratojë rritjen e numrit të tyre si dhe pagesën e tyre mujore. Kjo kërkesë reflekton dy çështje: e para, rëndësia që kjo strukturë paraqet dhe rritja e rolit të Ndërlidhësave Komunitar duke qënë të ndërgjegjshëm për faktin se popullsia e Tiranës vazhdon të rritet, ndërsa e dyta përmirësimi i këtyre shërbimeve për qytetarët.

³⁰ There approximately 222 CL-s in all Tirana 11 municipal units

³¹ Monitorimi “Njohja dhe Vlerësimi i Strukturës së Ndërlidhësit Komunitar nga qytetarët” u ndërmorr nga stafi i IDN-së, në Qershor 2006, në dy grupe qytetesh: I pari që aktualisht mban pozicionin e Ndërlidhësit Komunitar, respektivisht në Tiranë, Fier, Shkodër dhe dy qytete të cilët nuk e kanë të inkuorporuar ende këtë strukturë në institutet e tyre lokale respektive: Lushnja dhe Elbasani.

³² Diskutimet e Fokus Grupeve, që u realizuan nga stafi i IDN-së, në Gusht 2008, konsistonte në një seri takimesh e tryezash të rumbullakta me Ndërlidhësit Komunitar, dhe kryetarët e gjashtë njësisve bashkiake në Tiranë, që janë njësi bashkiake numër 1,4,5,9,10,11. Të pranishëm në diskutimet në grup ishin 100 pjesmarrës në total

Në mënyrë që të konsiderojë të plotë strukturën dhe rolin e Ndërlidhësit Komunitar në përgjithësi në Shqipëri, dhe në veçanti në Tiranë, IDN ka ndërmarrë një monitorim³¹ në komunitetet e qytetit të Tiranës. Kjo me qëllim për të kuptuar qartë perceptimet e tyre mbi strukturat e Ndërlidhësit Komunitar, mënyrat e përmirësimit të rolit të tyre në shërbimet e ofruara në komunitet por në të njëjtën kohë edhe për të vlerësuar zbatueshmërinë reale dhe njohjen e kësaj strukture nga komuniteti. Ky monitorim më vonë u ndoq nga të tjera aktivitete siç ishin Diskutimet në Fokus Grup³² me Ndërlidhësit Komunitar të Tiranës mbi shtjellimin e çështjeve të lidhura me funksionimin e kësaj strukture, si mënyra e selektimit dhe zgjedhjes së Ndërlidhësit Komunitar, përshkrimi i punës, shpërblimi dhe mundësia e zhvillimit të kapaciteteve.

Grupet e Bazuara në Komunitet (GBK) përfaqësojnë një tjetër instrument efikas që drejton përpjekjet për një qeverisje sa më përfshirëse dhe angazhim më të gjerë qytetar në politikat vendore dhe proceset vendim-marrëse. IDN-ja ka një eksperiencë të gjatë në këtë fushë dhe deri më sot ka arritur me sukses të implementojë projekte të ndryshme në këtë kuadër në qytetet e Laçit, Bajram Currit e Shkodrës. Që nga viti 2006, IDN-ja krijoi 10 GBK në dy njësi administrative në Shkodër, në një projekt të mbështetur nga Balkan Trust for Democracy (BTD). Nëpërmjet praktikave sensibilizuese dhe asistencën teknike që IDN-ja ka investuar në këtë projekt, 88 anëtarë të GBK-së kanë fituar aftësitë e nevojshme për organizimin dhe mobilizimin e komunitetit si dhe në të njëjtën kohë përpunimin e disa projekteve që përfshijnë bashkëpunimin me institucione dhe organizata të ndryshme me qëllim kryesor rritjen e qeverisjes me pjesëmarrjen e komunitetit. Ishte iniciativa e IDN-së ajo që siguroi hapjen e një Qendre Komunitare në afërsi të Qendrës Administrative, me qëllim për të siguruar një akses më të lehtë të komunitetit dhe aktorëve të tjerë.

Në Qendrën Komunitare, Kryebashkiaku i Shkodrës nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me GBK-të për të ndarë përgjegjësitë që kanë lidhje me shërbimet ndaj komunikimit të komunitetit me institucionet e qeverisjes lokale. Presioni pozitiv që GBK-të kanë ushtruar mbi përfaqësuesit e qeverisjes lokale po inkurajon bashkitë e ndryshme të ofrojnë asistencë në kohëzgjatjen e funksionimit të këtyre qendrave dhe zgjerimin e iniciativave me bazë komunitare në të gjithë qytetin.

Falë efektit që krijimi i strukturave të GBK-ve solli në qytetin e Shkodrës, Bashkia ka caktuar në buxhetin e vitit 2008 një fond specifik i projektuar për aktivitetet në komunitet. Në 2 vitet e fundit GBK-të e Shkodrës kanë qenë të afta të ndryshojnë perceptimin e vjetër të vullnetarizmit në qytet duke sjellë një definicion të ri mbi përgjegjësinë dhe mobilizimin në komunitet.

Struktura e Grupeve me Bazë në Komunitet shumë shpesh është një promovues i drejtëpërdrejtë i vendimeve të ndryshme të qeverive lokale. Konsolidimi i kësaj strukture është bërë nevojë e pashmangshme dhe në të njëjtën kohë është provuar se qëndrueshmëria e saj vazhdon të jetë një përgjegjësi lokale dhe gjithashtu parakusht në zhvillimet e qeverisjes vendore. Ndikimi pozitiv i këtyre projekteve ka qenë ndërtimi i bazës së nevojshme për të tjera nisma të IDN-së, në një përpjekje këmbëngulëse për të rritur mbështetjen publike dhe forcimin e partneritetit me përfaqësuesit e qeverisjes lokale. Në këto hapa synohet një zhvillim madhor

politik, jo vetëm në Shqipëri por në mbarë rajonin.

Pa dyshim si rrjedhojë e sfondit të ngjashëm social-ekonomik që Shqipëria ka me vendet e tjera të rajonit në aspektin e legjitimitetit në të kaluarën, çështjet aktuale dhe sfidat e së ardhmes, këto praktika pozitive të qeverisjes me pjesëmarrje të gjerë komunitare dhe mobilizimi i komunitetit mund të shërbejë si shembull i mirë edhe në vende të tjera të rajonit, natyrisht nëse adoptohet brenda kontekstit respektiv dhe duke marrë parasysh aspektin kulturor të komuniteteve përkatës.

Për më tepër, pjesëmarrja e komunitetit dhe skemat mobilizuese si dhe instrumentat që adresojnë hapësirën e krijuar midis komunitetit dhe qeverisjes vendore janë në mënyrë të veçantë efektive në shoqëritë multi-etnike siç është rasti i Kosovës apo Maqedonisë. Duke patur parasysh se këto vende karakterizohen nga një diversitet i madh i popullsisë që konsiston në minoritete të ndryshme etnike dhe gjuhësore, IDN-ja e konsideron modelin e Ndërlidhësit Komunitar dhe skemat përkatëse të mobilizimit të komunitetit nëpërmjet grupeve të ndryshme të interesit, si jashtëzakonisht të nevojshme në kontekstin e lartpërmendur.

IDN konsideron instrumentat e lart-përmendur si më efektivet për të arritur transformimin e politikave lokale me baza pjesëmarrjeje gjithëpërfshirëse në komunitet. Puna e bërë në lagjet lokale siç është përmendur edhe më lartë, ka rezultuar në forcimin e grupeve të konsoliduara me bazë në komunitet të cilat do të vazhdojnë të jenë efektive pavarësisht jetëgjatësisë së këtyre projekteve si dhe në të njëjtën kohë lobues aktiv në institucionet e qeverisjes vendore për politikën në interes të komunitetit. Instrumentet e komunikimit dhe ndikimit që GBK-të kanë përdorur për të influencuar vendim-marrjet politike në pushtetin vendor kanë rezultuar që këshilli bashkiak të aprovojë fonde mbështetëse për veprimtaritë e orientuara në komunitet. Për më tepër, autoritetet bashkiake po punojnë me IDN-në, grupet komunitare dhe komunitetin e biznesit për të themeluar Fondin Lokal të Besimit (Local Trust Fund), si dhe institucione me përfshirje lokale për të menaxhuar dhe mbështetur aktivitetet e grupeve me bazë qytetare në komunitet. Bashkia ka rënë dakort për të caktuar një buxhet vjetor për Fondin Lokal të Besimit. Kjo është një eksperiencë e cila ndodh për herë të parë në Shqipëri.

IX. Alternativat dhe Rekomandimet

Nuk ka dyshim se pjesëmarrja qytetare në vendim-marrjet politike sjell benefite të shumta jo vetëm për komunitetin si përfitues i drejtpërdrejtë të këtij procesi, por gjithashtu edhe për qeverinë, sektorin e biznesit dhe aktorë të tjerë që kanë interes në përmirësimin e marrëdhënieve qeveri-qytetar. Si pasojë është me rëndësi të veçantë të diskutohen *alternativat politike* të bazuara në një analizë të elementëve kyç të këtij kërkimi studimor. Argumentat na tregojnë se mënyra më e mirë është të shpjegojmë dhe argumentojmë *alternativën politike të mbështetjes së qeverisjes me pjesëmarrjen e komunitetit*, sepse ka një përfitim direkt në vendim-marrjet politike në mënyrë efektive, marrëdhënie më të mira qeveri-qytetar, si dhe rritja e transparencës bazuar në rolet respektive të aktorëve përgjegjës jo vetëm për të mbështetur, por në të njëjtën kohë edhe institucionalizuar qeverisjen me pjesëmarrjen e komunitetit. Në këtë kontekst:

- *Administrata Publike* (qeverisja vendore dhe lokale) duhet të jetë e vetëdijshme për nevojat e saj, duke kërkuar me këmbëngulje informacion nga publiku ose në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet institucioneve dhe mekanizmave të dizenuara për këto qëllime. Komunikimi efektiv mes qeverisë dhe qytetarëve përkthehet në transparencë, përgjegjësi dhe legjitimitet në politikat vendim-marrëse.
- *Organizatat qeveritare* duhet të sigurojnë se jo vetëm që ato përfaqësojnë zërin kolektiv të komunitetit, por edhe aktiviteti i tyre realizohet në mënyrë të tillë që shqetësimet e publikut dërgohen sistematikisht në debatet politike dhe procesin e formulimit të politikave vendim-marrëse. Kjo kërkon jo vetëm bashkëveprim konstant dhe dialog me publikun por gjithashtu përpjekje të përhershme për të mbajtur në nivel aktiv kapacitetet dhe njohuritë e tyre në proceset politike.
- *Qytetarët* kanë nevojë të jenë të vetëdijshëm se janë aktori më i fuqishëm në nxitjen dhe ndërmarrjen e reformave politike nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në çdo formë të mundshme të iniciativave që kanë të bëjnë me mobilizimin e komunitetit, si dhe të mbajnë qeverinë të përgjegjshme jo vetëm për cilësinë e shërbimeve të mandatuara, por edhe për përmirësimin e politikave të saj.
- *Shoqëria civile* (ku përfshihen organizatat me bazë në komunitet, shoqatat profesionale, sindikatat e punëtorëve etj) duhet të kuptojnë rolin e tyre informal në proceset politike si dhe limitet e këtij roli në formalizimin dhe funksionimin e politikave publike, përgjegjësia e të cilave mund të gjendet në institucionet qeveritare, kornizat ligjore dhe burimet e disponueshme.
- *Organizatat e bizneseve* gjithashtu luajnë një rol kryesor si marrëdhëniet shoqëri civile – qeveri, përse i përket realizimit të politikave publike. Nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre aktive në një partnership tre-palësh, ato mund të ndihmojnë dukshëm dhe fuqizojnë komunitetin si ‘sipërmarrës politik’. Prezenca e tyre në proceset politike gjithashtu është me mjaft benefit për interesat e korporatave të tyre.

Është shumë e rëndësishme që gjithashtu të reflektojmë mbi *alternativën e kundërt* – atë të vetëkënaqësisë me statuskuonë. Në fund të fundit, shtyrja e masave për të forcuar marrëdhëniet qeveri – qytetar ka pak gjasa të ndalojë erozionin e vazhdueshëm të besimit të qytetarëve tek qeveria. Në rastin më të keq, mund të kontribuojë në përkeqësimin e ndarjeve sociale dhe rritjen e pakënaqësisë me demokracinë si një model qeverisjeje. Në një kohë që shumë është arritur, shumë mbetet ende për t’u bërë³³.

³³ Caddy, J. & Vergez, C, 2007

Bibliografia

Adams, J.; USAID - Projekti për Administrimin Publik në Shqipëri, *Pjesëmarrja Publike – Një Guidë për Qeverisjet Vendore dhe Organizatat Jo-Qeveritare*, 1997

Caddy, J. and Vergez C., *OECD Shërbimi i Menaxhimit Publik, Qytetarët si Partnerë – Informacioni, Konsultimi dhe Pjesëmarrja Publike në Vendim-marrjet Politike*, 2001

Carothers, T., *Duke Ndihtuar Demokracitë Vendeve të Jashtme: Kthesa e të Mësuarit*, Botimi i Dytë, 2000

Coston, J., *Një model dhe Tipologji për Marrëdhëniet Qeveri – OJF*, Periodiku i Sektorit Jo-Fitimimprurës dhe Vullnetar. 27, No 3, 1998

Court et al, ODI/RAPID, *Angazhimi Politik: Si Shoqëria Civile Mund të Bëhet më Efektive*, 2006

E. Clay dhe B. Schaffer (red), *Hapësirë për Manovrim: Një shpjegim mbi Politikat Publike: Zhvillimi Politik dhe Rural*, (London: Heinemann, 1984)

Edgar L., Marshall C. dhe Bassett M, *Instituti mbi Qeverisjen dhe Partneritetin: Duke Vënë në Praktikë Principet e Qeverisjes së Mirë*, 2006

Fioramonti, L. & Heinrich, V. Finn, *Monitorimi Global Civicus i Situatës së Shoqërisë Civile: Perspektiva Krahasuese*, 2007

<http://2.ids.ac.uk/logolink/initiatives/öorkshops/ReCitEBrazil.htm> (Workshopi Ndërkombëtar mbi Burimet: Angazhimi Qytetar dhe Qeverisja Demokratike Lokale, Porto Alegre, Brazil, 6-9 December 2004)

Heinrich, V. Finn, *Ekspertiza Globale e Situatës së Shoqërisë Civile: Profilet e Vendeve*, 2007

Kingdon, J.W, *Axhendat, Alternativat dhe Politikat Publike*, (New York: Harper Collins, 1984)